



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 05 dhjetor 2019, në mbledhjen e XXVI (njëzetegjastë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DA; DPKGJ; DPZHE, DSHMS; DSHPMSh; DBF;) përfaqësues i OSBE-së z.Driton Nuli, përfaqësues të mjeteve të mediave dhe informimit, një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, duke konstatuar kuorumin (për momentin mungojnë 3 këshilltarë) dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të propozuar të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 20.11.2019, shtoi, thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Para se të fillojmë me punë, ju ftoj me 1 minutë heshtje në nderim të viktimave nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të viktimave nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, nëse ndokush ka diçka rreth rendit të propozuar të ditës, urdhëroni. **z.Arbër Blaku**, theksoi, deshta të japë një informatë rreth tërmetit në Republikën e Shqipërisë. Javën e kaluar përkatësisht të mërkurën, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së kemi marrë një iniciativë në mënyrë që të ndërmarrim një hap për ndihmë qytetarëve të Shqipërisë pas dëmeve të shkaktuara nga tërmeti. I kam thirr shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe të tjerët, jemi takuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit dhe kemi diskutuar për gjetjen e ndonjë forme për të ndihmuar Shqipërinë në këtë fatkeqësi të ndodhur, kemi kërkuar që Kryetari të thërret një mbledhje urgjente, jo të jashtëzakonshme, për shkak të kohës / afateve që kërkohen, por që Kryetari nuk ka reflektuar, andaj me që Kryetari i Komunës nuk ka reflektuar në këtë aspekt dhe po ai nuk është këtu prezent, dëshiroj nga Nënkyetari i Komunës të njoftohemi, përveç mbledhjes së komitetit për emergjenca që është thirr dhe mbajtur, çka është ndërmarrë tjetër lidhur me këtë çështje, ose ose ta fusim pikë

shtesë të rendit të ditës apo në të ndryshme, diskutim rreth mundësive për ndihmë Shqipërisë nga ana e Komunës së Podujevës. Mendoj se nuk është vonë edhe tani kur janë bërë 1 javë nga tërmeti, po ashtu mendoj se na takon si Kuvend i Komunës, ashtu sikurse Kuvendet e Komunave tjera të Kosovës, të paktën në mënyrë simbolike t'i ndihmojmë vëllezërit tanë në Shqipëri.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, këshilltari parafolës kërkoj një informatë, ose përfshirje të pikës shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës ose në pikën Të Ndryshme, diskutim rreth mundësive për ndihmë Shqipërisë. Jam dakord që kjo çështje të diskutohet në pikën Të Ndryshme, andaj nëse nuk ka këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, unë hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar, konstatimeve nga mbledhja e KPF-së dhe çështjes së ngritur paraprakisht.

Pas votimit, u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 03.12.2019, si dhe që në pikën të ndryshme, përveç çështjeve tjera të debatohet lidhur me mundësitë për ndihmë Shqipërisë nga ana e Komunës së Podujevës.

1. Propozim Plani Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Podujevës, 2019 – 2022

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë kjo pikë rrjedh nga Zyra e Kryetarit të Komunës, ftoj Nënkryetarin e Komunës për një fjalë hyrëse rreth këtij propozim Plani.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, sigurisht që materiali përkatës ju është dërguar me kohë dhe keni mund ta lexoni dhe analizoni. Është plan i cili ka dalë si nevojë dhe si kërkesë pas miratimit të Strategjisë shtetërore për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, dokument i cili është hartuar për periudhën 2018-2020.

Hartimi i këtij propozim plani është bërë nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim, Drejtoritë përkatëse të Komunës, Organizata vendore dhe ndërkombëtare, dhe Grupi punues për hartimin e këtij Plani, të cilin të gjithë besoj që e keni para vetës dhe nuk do të doja të lexoj pjesë nga ky dokument, mirëpo vetëm në pika të shkurtra e them se ky Plan përmban 10 objektiva që duhet të arrihen për periudhën përkatëse, pastaj rreth 50 masa dhe veprime. Po ashtu janë paraparë edhe bartësit e aktiviteteve me qëllim të zbatimit të këtij Plani, si dhe kostoja financiare për secilin aktivitet. E ceka se ky propozim plan është obligim ligjor për të gjitha Komunitatet e Kosovës e që shumica prej tyre pothuajse kanë hartuar plane të tilla të ngjashme, duke marrë për bazë Strategjinë e cekur, dhe i cili iu mundëson të gjitha organeve komunale që t'i trajtojnë në mënyrë institucionale të gjithë të riatdhesuarit në Kosovë, e që jemi në dijeni se ka një numër të madh të riatdhesuarve e që Komunitatet kanë për obligim ligjor t'iu dalin në ndihmë atyre personave në mënyrë që ata njerëz të fillojnë sërish të vazhdojnë me jetën e tyre, apo ka edhe raste pak më të rralla të cilët duhet të fillojnë jetën nga fillimi ngase siç jemi në dijeni ka raste që kanë shitur pothuajse gjithë pasurinë për të dalë në vendet Evropiane dhe më gjerë, por pasi që statusi i tyre në ato vende nuk ka mund të rregullohet, ata janë kthyer në Kosovë, andaj ne si Komunitet përmes Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrës për integritet evropianë i kemi trajtuar dhe jemi duke i trajtuar të gjithë individët dhe familjet e kthyer.

Prandaj, duke mos dashur t'ju marr kohë më shumë sepse të gjithë besoj që e keni lexuar dhe keni para vetës propozim planin në fjalë, ju ftoj ta miratoni këtë në mënyrë që të kemi një dokument apo akt të cilin mund ta quajmë edhe rregullativ, në bazë të asaj që është nxjerrë nga Strategjia

shtetërore, në mënyrë që Komuna e Podujevës të dijë saktë për të gjitha veprimet dhe gjitha masat që duhet t'i ndërmarr për të bërë më të lehtë jetën e qytetarëve tanë.

z. Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahë propozim Planin për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Podujevës, 2019 – 2022, dokument i cili si i tillë ka për qëllim riintegrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar e me këtë edhe ofrimin e shërbimeve për nevojat e tyre. Plani si i tillë ka një varg aktivitete të qëlluara por jo edhe të specifikuar me mjete financiare për të mundësuar realizimin edhe pse jemi të vetëdijshëm se disa aktivitete mbulohen edhe nga Ministritë përkatëse, mirëpo esenca është këtu, çka mund të bëjmë ne si Komunë për këto kategori për t'i riintegruar në shoqëri. Ne kemi parë që në dokument ekzistojnë disa synime të mira në përkrahje të atyre familjeve, por mungon se ato duhet konkretizuar, çështje e cila mendojmë se do të mund të bëhet shumë mirë përmes tri Drejtorive përkatëse Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së arsimit dhe Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku gjatë ndarjes së subvencioneve, prioritet duhet të kenë personat e familjeve të cilat kemi për qëllim t'i riintegrojmë, posa të bëhet thirrja për aplikim, të informohen personat në fjalë, mandej në kuadër të kritereve të kenë edhe prioritet dhe të jenë edhe përfitues të subvencioneve.

Duke shpresuar që ky dokument të shërbej si bazë e mirë për t'i trajtuar personat e riatdhesuar në mënyrën më të mirë të mundshme, ne si LDK japim mbështetjen tonë.

z. Bajram Ajeti, theksoi, lidhur me fushën e riintegrit apo riatdhesimit të personave të cilët kanë migruar në shtetet tjera, mendoj që baza ligjore, baza tjetër siç janë Strategjitë e ndryshme shtetërore që 3 të tilla duke filluar nga Strategjia Kombëtare dhe plani i veprimit, pastaj Strategjia për Romët Ashkëtinjtë dhe Egjiptasit si dhe Strategjia për Komunitete dhe Kthim. Në bazë të kësaj, si dhe duke qenë në dijeni se bazë e kësaj është edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ku për këtë fushë janë rreth 30 ligje dhe 18 akte nënligjore që rregullojnë këtë çështje. Duke pasur parasysh që ne si shtet i Kosovës dhe popullsia e këtij vendi jemi goditur mjaft nga kjo dukuri, dihet për rrethana të ndryshme, nga lufta, nga koha e pushtimit, pastaj nga keqeverisja në Kosovë posaçërisht vala e të ikurve në vitin 2015. Propozim plani në fjalë sigurisht që do të miratohet, mirëpo nuk di a ka ndokush informata se çka është bërë deri më tani sa i përket këtij procesi, a është bërë ndonjë veprim, si ka rrjedh riatdhesimi apo edhe riintegrimi i bashkëkombësve tanë të cilët kanë migruar dhe nuk kanë pasë mundësi të fitojnë të drejtën e qëndrimit goftë të përkohshëm apo të përhershëm.

Duhet të jemi në dijeni se problemi është te zbatimi i këtij dokumenti e jo sjellja e planeve të tilla, por edhe implikimet buxhetore, mirëpo megjithatë meqë janë të miratuara këto dokumente ligjore të cilat obligojnë institucionet e Kosovës që të merren me këtë problematikë mjaft të ndjeshme e që nuk janë vetëm 3 Drejtori po janë shumë fusha sipas të cilave duhet trajtuar personat e riatdhesuar.

Në bazë të informacioneve që kemi ka raste që janë kthyer apo riatdhesuar por që trajtimin nuk e kanë pas ashtu siç duhet, shembull kemi Ylber Uka i cili është riatdhesuar, dhe kemi të rregulluar këtë çështje ku duhet t'iu sigurohet strehim, qëndrim i përhershëm, dhe fundja edhe pagesa e qirasë për 6 muaj me mundësi të vazhdimin edhe për 6 muaj tjerë, por që të përmendurit sa kam informata vetëm 1 muaj i është paguar qiraja. Pastaj kemi edhe problemet shëndetësore që duhet të trajtohen ata persona, involvimi i Qendrës për Punë Sociale dhe institucionet tjera. Kështu që mendoj se Plani përkatës është i mirë dhe është i bazuar në Ligj, akte nënligjore dhe Strategjitë përkatëse, mirëpo problemi qëndron se si do të zbatohet në praktikë në Komunën e Podujevës.

Pra ne do ta votojmë këtë propozim plan, por do të përpiqemi të përcjellim vërtetë se a do të zbatohet. Obligim janë të gjitha Drejtoritë, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, pastaj është edhe Komisioni Komunal, të cilat duhet të jenë funksionale, të pavarura dhe të jenë të gatshme të marrin problematikat seriozisht dhe të bëjnë zgjidhje të problemeve me qëllim që ndoshta në të

ardhmen me rritjen e shpresave të këtij populli me një qeverisje të re, dukurinë e lëshimit të atdheut nga qytetarët tanë do ta kemi të zvogëluar dhe të njëjtit ta shohin perspektivën në vendin e tyre.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë se plani si i tillë është i mirë dhe janë personat përgjegjës për zbatimin e tij dhe besoj se do të zbatohet maksimalisht në kuadër të mundësive që kemi si Komunë.

Vlen të nënvizohet se këshilltarët të cilët nuk ishin prezent në hapje të kësaj mbledhje, tani janë prezent, do të thotë si Kuvend jemi të gjithë prezent, pra kjo ishte sa për procesverbal.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës lidhur me propozim planin në fjalë, ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa bashkërisht u morëm vesh të gjithë që sot në mbledhjen e Kuvendit të jetë prezent zyrtari përkatës i cili e ka hartuar këtë dokument z.Ylber Salihu, në mënyrë që për pyetjet konkrete apo për qëndrueshmërinë e planit të na jap përgjigjet adekuate, edhe pse formën teknike të planit e prezantoj Nënkyetari i Komunës.

Nuk jam në dijeni a ka pas plan të tillë miratuar më parë nga Komuna e Podujevës, mirëpo sa kam shikuar këtë parashihet raportime në baza tremujore për personat e riadhesuar.

Mendoj se si dokument i paraparë duhet të kaloj/të miratohet, por tani më duhet ta pyes Nënkyetarin e Komunës meqë ky e prezantoi këtë dokument ngase zyrtari kompetent nuk është prezent këtu, përkatësisht, ku propozim plan parashih plan për strehim, për shkollim, për financim, për trajnim, për organizim të kurseve të mësimin, për organizim dhe angazhim të OJQ-ve për trajnimin e atyre personave, parashih edhe përmbyllje të dosjeve fizike kur personi i riadhesuar i kryen të gjitha sistemet në bazë të ligjit dhe kalon në stabilitet.

Do të ishte mirë që Kuvendi i Komunës pasi ta miratoj këtë plan të informohet për disa çështje, e them këtë ngase këshilltari parafolës veç e përmendi një rast me emër dhe mbiemër, të cilin besoj se të gjithë e njohim, por ka edhe raste të tjera dhe ne si Kuvend nuk jemi në dijeni për numrin e personave të riadhesuar deri më sot, numrin e personave të cilët i kanë shfrytëzuar të drejtat e tyre, madje ky plan parashih edhe kosto buxhetore komunale ngase janë detyra të ndara sa i përket përgjegjësisive të nivelit lokal, dhe tani i nderuari Kryesues dhe i nderuar Nënkyetar i Komunës buxheti që është miratuar tani për vitin 2020, zyrtari për integritet evropiane sa ka paraparë buxhet për atë kategori të personave të riadhesuar, sa kam vërejtur unë, nuk ka asnjë cent të planifikuar, përveç buxhetit të planifikuar për pagave të atyre zyrtarëve, andaj ne mund ta miratojmë këtë propozim plan, por jemi dëshmitarë të gjithë që buxhetin e kemi miratuar por nuk është paraparë asnjë cent për këtë fushë që po diskutojmë, askush nuk ka planifikuar e as propozuar buxhet për këtë çështje, të paktën do të duhej të planifikoheshin 5,000 – 10,000 €, andaj nuk di si miratohet plan pa buxhet kur i njëjti duhet të zbatohet dhe sigurisht që do të ketë persona që do të riadhesohen dhe riintegrohen e që iu takon një e drejtë e tillë.

Mandej kam pyetje për Nënkyetarin, sa mjete buxhetore keni ndarë për OJQ-të të cilat do t'i trajtojnë personat e riadhesuar dhe riintegruar, pastaj a keni ndonjë banesë kolektive (e që nuk jam në dijeni se Komuna ka ndonjë dhomë të paktën për këtë çështje) apo sa mjete keni të ndara për qiratë e personave të riadhesuar, si do të veproni në këtë aspekt. Ka familje që kanë lëvizë në shtetet e jashtme e që me siguri që kanë pasë edhe fëmijë të cilët kanë ndërprerë mësimin dhe njëkohësisht kanë ngecë në këtë proces e që pas riadhesimit duhet të vazhdojnë mësimin plotësues në mënyrë që ta nxënë hapin andaj çfarë strategjie ka përdorur Drejtoria e Arsimit në këtë rast, e që konsideroj se nuk ka asnjë plan në këtë drejtim, madje madje në këtë plan nuk ka të paraparë as kosto komunale e që pastaj me rishikimin e buxhetit do të mund të ndaheshin mjetet buxhetore. Pra ai zyrtar që ka hartuar këtë dokument, këtë e ka bërë vetëm sa për të sjellë në Kuvend diçka të shkruar dhe është përpjekur ta bëjë sa më voluminoz duke menduar që këshilltarët nuk do ta lexojnë, e që as vetë se ka lexuar besoj, mirëpo po të ishte zyrtari kompetent për integritet evropiane prezent, i cili ia ka nxënë

vendin ndokujt, unë do ti parashtroja pyetje, sa i ka kushtuar Komunës së Podujevës, në bazë të statistikave të lëvizjes së qytetarëve të Podujevës jashtë vendit, të cilitdo nacionalitet, cila është strategjia e juaj lidhur me Drejtorinë e Arsimit, për nxënien e hapit në shkollim, cilat janë organizatat joqeveritare që keni identifikuar që janë pjesë e rrjetit të OJQ-ve në Podujevë dhe që mund ta kryejnë trajnimin psiko-social për ata persona.

Kështu që dokumentin ne mund ta miratojmë, por pa asnjë përgjigje nuk di si, ndërsa ai i cili ka hartuar këtë dokument shumë mirë i ka paraparë, por pa asnjë prej këtyre që i thash dhe pa qenë këtu, vërtetë është turp ose është pa aftësi profesionale, ndërsa meqë Nënkryetari e bëri prezantimin e këtij plani unë pyetjet e cekura do t'ia adresoja këtij, ose në çoftë se nuk është i gatshëm ky të jap përgjigje, këtë pikë e kalojmë në fund deri sa të vie zyrtari përkatës Ylber Salihu si hartues dhe të jap përgjigjet po ai.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se është mirë ta miratojmë këtë propozim plan, kurse për informata dhe raporte tjera besoj që mund të kërkojmë në një mbledhje tjetër ngase besoj që zyrtari përkatës ka punuar në këtë drejtim por që besoj që personi apo zyrtari më kompetent për këtë çështje është Nënkryetari i Komunës për arsye se këtë propozim plan e ka hartuar një komision i ngritur e që kryesues komisioni ka qenë vetë Nënkryetari i Komunës, pra kjo ishte vetëm sa për informatën e juaj.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, po del sikurse që ky dokument aq i rëndësishëm është shkruar prej një personi/zyrtari, edhe pse unë në fillim e sqarova se për hartimin e këtij dokumenti kanë marrë pjesë shumë akterë, qoftë organizata vendore dhe ndërkombëtare përmes ekspertëve të tyre, zyra komunale për komunitete dhe kthim, zyra për integritime europiane, dhe grupi punues për hartimin e këtij plani, në krye të të cilit kam qenë unë dhe nuk është praktikë që në Kuvendin e Komunës të raportojnë shërbyesit civil por raportojnë përfaqësuesit politik, përjashtimisht nëse ka ndonjë temë për të cilën patjetër duhet të raportojnë ndonjëri prej shërbyesve civil. Këshilltari parafolës z.Rafet Llapashtica më tepër foli për një lloj raporti të cilin do kishte mirë ta kishim për të kaluarën se çka është bërë se sa për vet dokumentin i cili është plan komunal për riintegrimin apo plan i veprimit i cili parasheh masat që duhet të ndërmerren për t'iu lehtësuar qytetarëve tanë për riintegrimin e qëndrueshëm të tyre. Vazhdimisht, për çdo ditë pothuajse ka persona të cilët kthehen apo riatdhesohen dhe Zyra për integritime europiane bashkërisht me Zyrën komunale për komunitete dhe kthim përkujdesen duke zhvilluar intervista me ata persona pas dokumentacionit që marrin nga Ministria përkatëse, për atë person, shohin nevojat apo kërkesat e individit apo familjes së riatdhesuar, merren të gjitha informacionet për fëmijët e tyre, nëse ka, sa i përket shkollimit, udhëzohen se çfarë duhet të bëjnë më tutje sipas Udhëzimeve Administrative të MASHT të cilat përcaktojnë qartë aktivitetet dhe procedurat që duhet ndjekur se kur një fëmijë / nxënës duhet ta përsëritë vitin shkollor, kur një fëmijë duhet të mbaj mësim plotësues sepse kohëzgjatja e këtyre personave jashtë Kosovës nuk është e njëjtë ku ata që janë larguar vetëm 2-3 muaj shembull, vetëm duhet të kalojnë nëpër procedura të një mësimi plotësues pa kosto financiare sepse kjo bëhet në shkolla dhe me të njëjtit mësimdhënës, por nëse një nxënës ka kaluar më shumë se 2/3 e atij viti përkatës, atëherë ai nxënës duhet ta përsëritë klasën apo vitin mësimor, pra janë të rregulluara me akte ligjore dhe nënligjore të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Kostoja financiare, mbi 95% e masave dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren, janë pa kosto shtesë financiare por kryhen përmes personave që punojnë në institucione dhe që paguhen për t'iu ndihmuar ata persona, ta zëmë, ka shumë fëmijë të cilët kanë kryer 1 deri në 3 klasë në Gjermani dhe posa të kthehen atyre ju ndihmohet ta kryejnë nostrifikimin e diplomave ose certifikatave si dëshmi që kanë vijuar mësimin në atë shtet, për të mund të vazhduar procesin mësimor pastaj në Kosovë.

Pra shumica e aktiviteteve sa i përket zbatimit të këtij plani janë pa kosto shtesë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Nënkryetari i Komunës po diskuton sikurse të ishte bisedë private në ndonjë odë. Persona të riatdhesuar ka edhe sot në Podujevë, të të gjitha nacionaliteteve, ata persona që janë kthyer duhet t'ju paguhet strehimi, qoftë edhe një rast i vetëm në Komunë nëse është dhe që i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret, është kostoja financiare.

Pyetja tjetër, a ka ndonjë zyrtar nga kjo Komunë që kryen trajnim psiko-social për personat e riatdhesuar deri më tani ngase për ata që do të kthen është shumë hipotetike, nëse jo cila OJQ është e angazhuar për këtë çështje, nëse po sa është kostoja e kryerjes së asaj pune apo ndoshta është punë vullnetare që të paktën t'ia japim një mirënjohje deklarative asaj OJQ-je, prandaj i nderuar Nënkryetar me mua nuk mund të bisedoni ashtu vetëm sa për të kaluar procesi, nëse kam qëndrim personal për ta kaluar procesin e kaloj, nëse jo për shkaqe administrative nuk e kaloj asnjëherë.

Sa raste të dosjeve të mbyllura fizike keni për peronat që kanë kryer të gjitha obligimet dhe që kanë përfunduar në stabilitet. Cilat OJQ janë të angazhuara për trajnim psiko-fizik dhe a e kryejnë punën në mënyrë vullnetare apo me pagesë. Sa raste i keni me strehim dhe sa qira paguani dhe cilat janë preventivat për qytetarët që do të kthehen. Pra këto janë pyetje konkrete sepse Nënkryetari e tha që nuk ka kosto shtesë, andaj nëse mund të na tregoni që në rast se kthehen 10 qytetarë dhe ju tregoni vendin se ku do të strehoni është ok, por nëse keni rastin sikurse që ishte ai që u përmend më parë Ylber Uka i cili është kthyer dhe asnjëherë nuk i janë dhënë mjetet financiare që i takojnë, dikush duhet të jap përgjigje, dhe ai duhet të jetë dikush nga Ekzekutivi i Komunës sepse ne këshilltarët e Kuvendit nuk kemi kompetenca për një gjë të tillë. Çështja tjetër, Nënkryetari i Komunës paska qenë kryesues i komisionit për hartimin e këtij dokumenti, andaj përse i nderuar nuk keni paraparë linjë buxhetore ku është miratuar buxheti i Komunës për vitin 2020, kurse në anën tjetër ju kanë tepruar 2 milion e gjysmë në vitin e kaluar si sufid, kurse asnjë cent nuk ndani për personat e riatdhesuar.

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, mora fjalën vetëm për një detaj përkatësisht për shqetësimin që u cek në lidhje me personin e riatdhesuar Ylber Uka për të cilin është e vërtetë se është qytetarë i Komunës tonë dhe i cili është ndihmuar në bazë të mundësive tona që kemi buxhetore, në vitin 2017 është ndihmuar me 300€, në vitin 2018 është ndihmuar me 200€, pastaj në vitin 2019 nuk ka aplikuar fare. Statusi i tij social ka ndryshuar dhe ai person punon si taksist. Pastaj këtij personi i është subvencionuar qiraja 24 muaj nga Ministria përkatëse, ndërsa tani i njëjti është në listën e donatorëve për ndërtimin e shtëpisë, prandaj mund të themi se ai person është riintegruar mirë, punon, statusi i tij social ka ndryshuar dhe po mendoj se tani i përmenduri ka gjetur veten.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj parafolësit për kontributin e dhënë rreth kësaj teme, përkatësisht rreth propozim planit por edhe çështjeve tjera të ngritura. I gëzohem faktit që personi i cekur i riatdhesuar sipas asaj që e potencoj drejtori parafolës është riintegruar mirë dhe ka gjetur veten sa i përket risocializimit.

Unë mendoj se propozim plani është mirë të del në votim, kurse sa i përket pyetjeve të parashtruara nga këshilltari z.Rafet Llapashtica mund të kërkohet nga zyrtari përkatës të sjellë një informatë se çfarë është bërë deri më tani lidhur me fushën e riatdhesimit dhe rinintegrimit.

Konkretisht nëse ky plan miratohet, të mbetet si rekomandim i Kuvendit që të bëhet përpjekje që në kuadër të mundësive të gjenden mjete buxhetore me qëllim të realizimit të aktiviteteve të parapara në këtë plan, andaj si të tillë e hedh në votim, sipas materialit dhe rekomandimeve të KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 22 vota për, asnjë votë kundër dhe 8 vota të përmbajtura u miratua plani Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Podujevës, 2019 – 2022.

2. Propozimi Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2020

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se është ngritur një grup punues nga të gjitha subjektet përfaqësuese në Kuvend, për hartimin e këtij dokumenti. Si grup punues natyrisht se jemi ulur dhe kemi përgatitur këtë propozim fillestar të cilin e kemi sjellë para kuvendit për shqyrtim, debat dhe eventualisht plotësim ndryshim, andaj urdhëroni kush dëshiron fjalën.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, siç jeni në dijeni në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës u krijuar grupi punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2020, pra ishte i mandatuara ta bëjë këtë punë dhe ne si grup punues për një kohë të shkurtër u munduam t'i hedhim konturat e përgjithshme të një plani, përkatësisht atyre pikave më përmbajtjesore dhe më kryesore që do t'i shqyrtojmë ne si Kuvend i Komunës. Pra të gjitha propozimet e adresuara gjatë kohës së hartimit të këtij plani ishin nga dy drejtime, ato të sjella nga Ekzekutivi i Komunës që në fakt ishin ato pika që janë periodike të cilat pothuajse i kemi për çdo vit, me përjashtim të disa pikave që ishin më konkrete dhe përveç kësaj janë edhe dy pika shitesë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit të cilat u përfshinë dhe u rekomanduan nga mbledhja e KPF-së të cilat keni mund t'i shihni në konstatimet përkatëse, ndërsa kemi edhe pikat e propozuara dhe të përfshira nga këshilltarët e Kuvendit të Komunës të cilat kryesisht në kuptim të informatave gjatë gjithë vitit që duhet të na japin Drejtoritë përkatëse, prandaj ne si grup punues u dakorduam e që po ashtu dua të përçoj këtë mesazh në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës që të gjithë drejtorët e Drejtorive t'i sjellin informatat e parapara gjatë vitit të ardhshëm në mënyrë që të na informojnë me ecurinë e punëve të kryera në Drejtoritë përkatëse dhe jo vetëm kaq por t'i sjellin varësisht në muajt kur ne i kemi paraparë për shkak se jemi munduar të gjejmë një arsyeshmëri dhe të përcaktojmë kohën kur ato Drejtori e kanë volumin më të madh të punëve dhe kanë për çka të na informojnë këtu në Kuvend. Përveç kësaj, pika më e rëndësishme që u dakorduam dhe që besoj se do të dakordohemi bashkërisht edhe këtu është që të kërkojmë që ky plan i punës të zbatohet në përpikëri dhe jo të mbetet si i tillë, mirëpo prap se prap duke qenë të vetëdijshëm se ky ndoshta nuk është plani më i mirë i mundshëm si dhe që ka mundësi për plotësime dhe pasurim edhe me pika tjera që sigurisht do të sjellën gjatë vitit 2020, ne prap se prap mendojmë se është e domosdoshme të kemi një plan i cili ka pikat kryesore që ne do ti diskutojmë.

Përveç kësaj, për fund dua t'i falënderoj të gjithë kolegët në krye me Kryesuesin e Kuvendit për frymën e mirë bashkëpunuese që kishim gjatë hartimit të këtij dokumenti dhe që të gjitha çështjet për të cilat u vendos ishte një unanimitet i plotë nga të gjithë anëtarët e grupit.

z.Fitim Haziri, theksoi, meqë edhe përfaqësuesi nga radhët tona të LVV-së ka qenë pjesë e këtij grupi punues anëtarë të të cilit kanë hartuar bashkërisht këtë propozim plan, ne e mbështesim por me një kusht që ky plan si i tillë të zbatohet në vitin 2020 e jo vetëm të ndodh sikurse plani i këtij vitit që po e lëm pas për të cilin nëse e shikojmë vërejmë se shumë shumë pak është zbatuar. Pra kjo ishte kërkesa jonë e vetme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket zbatimit të planit të punës për këtë vit, ne do ta kemi raportin në seancën e janarit besoj. Konsideroj se është zbatuar deri në një masë të madhe e jo ashtu siç u tha nga parafolësi, shumë pak.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, do të doja që të ruhen deklaratat e secilit këtu sot sa i përket planit të punës dhe gjithashtu do të doja që të jenë më koncentrik në deklarata secili prej përfaqësuesve politik në këtë Kuvend sa i përket mbikëqyrjes së realizimit të planit të punës. Pra kjo nënkupton që të zbatohet plani i punës së Kuvendit ashtu siç e ka sjellë grupi punues dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Kam një propozim i cili është edhe ligjor edhe që kërkohet, mendoj që do të ishte mirë që qysh në seancën e radhës, qoftë edhe nëse ndodh në këtë vit që jemi, të futet pikë e rendit të ditës, ngritja e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të komiteteve të fshatrave dhe këshillave të fshatrave.

Pra është një obligim ligjor që nuk është kryer nga Komuna e Podujevës, çështje për të cilën janë nxjerrë gjitha aktet ligjor dhe nënligjore, andaj është përgjegjësi e Ekzekutivit të Komunës dhe kërkesë e qytetarëve e që ne të gjithë këtu përfaqësojmë qytetarë të koncepteve të ndryshme politike. Lidhur me këtë çështje, ne kemi marrë pjesë në një punëtori të organizuar nga një OJQ ku pjesëmarrës ishte edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Pejës i cili paraqiti një punë e cila zgjatë më shumë se 6 muaj deri sa të zgjedhën rreth 30 këshilla sikurse që kemi ne si Komunë e Podujevës, mirëpo asnjë zyrtar komunal nuk ishte prezent në atë punëtori, Kryesuesi kishte qenë i zënë, por të paktën ndokush do të ishte mirë të ishte prezent në atë punëtori.

Kështu që shumica e Komunave të Kosovës e kanë kryer këtë obligim ligjor, kurse ne nuk kemi filluar asnjëherë, madje nuk është ngrit as Komision, prandaj kërkesë e imja është që të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës tema të cilën e ceke e që besoj se disponim kanë të gjithë por nuk di përse nuk është përmend nga askush që të futet në këtë propozim plan. Pra të futet në plan të punës kjo kërkesë e imja, kurse pastaj a fillon me procedura apo jo Ekzekutivi i Komunës është çështje tjetër, e që është edhe obligim i yni si Kuvend që të themelojmë komisionin përkatës në bazë të përfaqësimit politik në Kuvend, natyrisht duke marrë edhe praktikën e Komunave tjera sa i përket përbërjes së komisionit në fjalë.

Kështu që unë kisha këtë kërkesë që kjo pikë e rendit të ditës të futet maksimum në seancën e parë të janarit 2020, përkatësisht ngritja e komisionit të përzgjedhjes si dhe ngritja e komisionit të ankesave, për arsye se janë obligative të ngritën këto dy komisione, në mënyrë që kur do që të filloj ky proces, të paktën komisionet të jenë të ngritura.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jam në dijeni se ky propozim plan mund të plotësohet dhe ndryshohet sepse është i hartuar dhe miratohet nga ky Kuvend, fjala është për pika shtesë të cilat mund të lindin si të domosdoshme gjatë vitit për interesat e përgjithshme të qytetarëve të Komunës së Podujevës të cilat mund të inkorporohen edhe më vonë, mirëpo ky dokument është një bazament i mirë që në vitin 2020 të hyjmë me një plan të punës i cili përfshinë të paktën pikat e përgjithshme të domosdoshme që duhet të shqyrtohen gjatë vitit.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votimi propozim planin e punës së Kuvendit për vitin 2020, sipas materialit të dërguar dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

3. Raporti mbi diskutimin publik të draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës

z.Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni raportin në fjalë. Jemi munduar që secilin propozim, sugjerim nga kush do që është sjellë ta inkorporojmë në draftin final të Strategjisë dhe shpresoj që me miratimin e juaj, Podujeva do ta ketë Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit për periudhën 2019 – 2021.

z.Adnan Zymeri, theksoi, ashtu siç është thënë në seancën paraprake kur kishim për diskutim draft Strategjinë në fjalë, Strategji e cila paraqet një dokument mjaft të rëndësishëm orientues për Komunën e Podujevës lidhur me atë se çfarë pretendohet të arrihet në fushën e turizmit.

Gjatë diskutimit publik, unë personalisht kam dhënë kontributin tim profesional duke adresuar rekomandimet e detajuara në formë të shkruar në DPZHE, rekomandime të cilat theks të veçantë kanë korigjimin e vizionit dhe disa elemente të tjera të cilat i gjeni të bashkëngjitura me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së për këtë seancë.

Në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së falënderoj të gjithë qytetarët dhe Shoqatën e Alpinistëve dhe Bjeshkatarisë “Llapi” të cilët me rekomandimet e tyre kanë kontribuar në pasurimin e këtij dokumenti, si dhe Drejtorinë përkatëse për bashkëpunimin e mirë dhe inkorporimin e rekomandimeve tona në dokumentin në fjalë.

Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështesim këtë raport, përkatësisht Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit, duke njohur rëndësinë e këtij dokumenti dhe njëkohësisht ftojme edhe grupet tjera të Kuvendit të votojnë pro procedimit për implementim.

z.Fitim Haziri, theksoi, LVV-ja në vazhdimësi ka kërkuar që me kohë të kemi hartimin e Strategjisë Zhvillimore dhe strategjive sektoriale duke përfshirë këtu edhe këtë Strategji për të cilën po diskutojmë e cila për çudi është e hartuar për një vit që po lëm pas, përkatësisht për vitet 2019 – 2021 kurse tani jemi në muajin dhjetor të vitit 2019, kjo është një argument që ju edhe kur planifikoni e bëni për të kaluarën e shumë pak planifikoni për të ardhmen.

Kohëve të fundit në Kuvend kanë ardhur për miratim 2 Strategji (Zhvillimore dhe kjo për Turizëm), kjo është një rrjedhë jo logjike sepse paraprakisht do të ishte dashur të miratohej Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, pastaj Strategjia e Turizmit.

Komuna jonë ka një pozicion të mirë strategjik të mirë të resursve natyrore, male, fusha, liqenj, ujëra shërues. Në çdo analizë sado sipërfaqësore dihet qartë se Komuna ka tri mundësi për zhvillimin e turizmit: Parkun nacional të liqenit të Batllavës, ku është një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e turizmit ku ka një kombinim perfekt si mjedis, male, fusha dhe uji, dhe ku ka mundësi të ketë qendra skijimi, ushqime për qëllime mjekësore për shkak të ajrit të pastër dhe rekreacione tjera. Malet e Llapit dhe Gollakut për qendra të skijimeve dhe për pushime malore. Banja shëruese që janë dy dhe ka studime që mund të ketë edhe më shumë.

Një Strategji duhet të studiohet dhe të parashihet hapa konkret për zhvillimin e këtyre mundësive në mënyrë që të zhvillohet sektori i turizmit. Ashtu siç e cekëm në fillim, ka një rrjedhë të zhvillimit të gjërave se si duhet të rrjedhin: 1-Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal që ende nuk është sjellë për miratim dhe e cila është një Strategji vetëm sa për të thënë sikurse kjo për të cilën po diskutojmë tani e cila do të ngelte vetëm në letër e kur jemi në dijeni se janë shpenzuar mbi 13,000.00€ për këtë dokument, 2-Plani Zhvillimor Urban i Komunës së Podujevës, plan të cilin ne si Komunë nuk e kemi, 3-pas këtyre duhet ta kemi Strategjinë e Turizmit që në kuadër të dy dokumenteve paraprake të ketë harmonizim të qëllimeve të kësaj Strategjie.

Kjo Strategji farse që nuk është paraqitur për miratim, në pjesën dërmuese të tekstit të saj është një përshkrim i resurseve të Komunës tonë që është marrë nga librat e gjeografisë apo nga interneti dhe një pjesë tjetër janë jo objektiva të shprehura në terma të përgjithshëm e që nuk asnjë plan konkret për zhvillimin e turizmit. Në këtë plan strategjik është përmendur që kompania ka ekspert, për çudi është se përse nuk keni cekë cilët janë ata ekspert të kompanisë që është marrë me këtë fushë.

Për zhvillimin e turizmit nevojiten mjete financiare, kurse në bazë të Kornizës Afatmesme të shpenzimeve nuk janë paraparë investime në këtë fushë, e që shtrohet pyetja, si të këtë zhvillim pa investim. Ne si LVV propozojmë që për zhvillimin e turizmit të ndërmerren këto hapa;

-Hartimi i planit zhvillimor urban ku në kuadër të tij do të hartohet edhe plani zhvillimor i parkut të liqenit të Batllavës dhe të parashihen qartë investimet për zhvillimin e këtij parku, e jo me investime ad-hoc në atë zonë e të cilat më shumë janë degraduese dhe që dëmtojnë zhvillimin e turizmit, por të kalohet në investime të planifikuara që e ruan parkun.

-Identifikimin e lokacioneve ku do të mund të investohet në qendra të skijimeve dhe shpallja e konkursit ndërkombëtar për hartimin e projekteve dhe pas hartimit të tyre të shpallet oferta ndërkombëtare për investime siç është rasti i projekteve “Borea” në Komunën e Pejës, e që ne mendojmë se lokacioni i përshtatshëm është në malet e Bajgorës.

-Identifikimin e lokacioneve të ujërave shërues dhe për këto projekte investimet të jenë me partneritet publiko privat.

-Të merren hapa urgjent për ruajtjen e maleve në mënyrë që të jetë një mundësi më e madhe për zhvillimin e turizmit malor dhe në kuadër të kësaj të krijohen shtigje të ecjes dhe biçikletave në vargmalet e Llapit dhe Gollakut.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim të parafolësit, malet e Shalës së Bajgorës nuk janë në kompetencë të territorit të Komunës tonë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim raportin në fjalë, përkatësisht Strategjinë për Zhvillimin e Turizmit në Komunën e Podujevës pasi që ka kaluar të gjitha procedurat paraprake dhe jemi në shqyrtimin përfundimtar.

Gjatë diskutimit publik kemi dhënë propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tona, andaj edhe besojmë se ku dokument është mirë të miratohet sot.

z.Mirsad Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, po detyrohem të marrë fjalën nga disa prej diskutimeve paraprake. Në seancën paraprake kur është paraqitur ku draft dokument kemi marrë mbështetje pothuajse unanime, por megjithatë efektet tani veç se po dihen. Këshilltari z.Fitim Haziri nuk ka marrë pjesë fare në debat publik dhe nuk keni dhënë asnjë rekomandim, andaj nuk e ka qëllimin për të shërbyer një dokumenti shumë të mirë i cili për herë të parë Komuna e Podujevës po e miraton, dhe si i tillë ky dokumenti i dyti në nivel Kosove që është bërë, andaj të mësohemi njëherë e mirë që kur kemi të bëjmë me një të mirë të përgjithshme publike, e në këtë rast punë specifike siç është fusha e turizmit, t’ia japim ndihmën sepse jeni pjesë e këtij institucioni e që nuk e keni dhënë (i drejtohet këshilltarit të cekur) edhe pse ju kam ftuar ashtu siç e kam ftuar edhe këshilltarin z.Fatmir Rudri të cilin e falënderoj publikisht për kontributin e dhënë në fushën, si dhe z.Patriot Rudari po ashtu, si dhe z.Adnan Zymeri, por që edhe përkundër ftesës që i kemi bërë z.Florent Hasanit që në cilësinë e historianit por që nuk është ardh, prandaj unë jam këtu që të mbrojë interesin e qytetarëve të Komunës së Podujevës e jo të individëve apo pakënaqësitë e individëve të caktuar. Pra nuk dëshiroj të lëshohem në temat që z.Fitim Haziri i ngriti sepse që të gjitha ato janë të parapara në dokumentin në fjalë i cili natyrisht që nuk është i përkryer, por duke u nisë nga ajo në nivel vendi mund të them se është më i mirë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është e vërtetë se dokumenti në fjalë ka qenë në diskutim publik si dhe janë zhvilluar edhe debate publike, andaj të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këto dy aktivitete sigurisht që kanë dhënë kontributet e tyre në funksion të pasurimit sa më shumë të këtij dokumenti.

z.Fitim Haziri, theksoi, po e shoh që drejtori parafolës është paksa i shqetësuar, por që nuk e di arsyen sepse nuk ka nevojë të shqetësohet. Në një prej seancave të kaluara pikë e rendit të ditës ka qenë që kjo draft Strategji të vëhet në diskutim publik, por jo diskutim rreth këtij dokumenti, ndërsa debatet publike bëhen me qytetarë dhe me grupe të caktuara me fokus të caktuar në mënyrë që të japin vërejtjet dhe propozimet e tyre.

I nderuar drejtor, nuk don koment kjo që të sjellësh për miratim një dokument i cili është për vitin 2019 – 2021, kurse në vitin 2019 po lëm tash ndërsa ti çka ke planifikuar në vitin 2019.

z.Mirsad Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, e sqaroi parafolësin që dokumenti i Strategjisë në fjalë është për zhvillimin e turizmit, por jo për ngritjen e pikave të turizmit sepse as nuk ngritën pika të turizmit në vitin 2020 as në vitin 2021. Sa i përket periudhës kohore, ky dokument ka mund të martohet në gjysmën e vitit 2019, por për hir të një konsultimi të gjerë ka marrë kohë më shumë se që duhet, andaj ajo që ju e cekët është vetëm një çështje teknike dhe nuk ka asgjë të bëjë me thelbin e Strategjisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se kjo Strategji është mjaft e rëndësishme për Komunën e Podujevës, përkatësisht për zhvillimin e turizmit.

Drafti i parë i këtij dokumenti ju është dërguar në një prej seancave paraprake të Kuvendit ku edhe me miratimin e juaj është vënë në diskutim/debat publik, e që ka kaluar të gjitha ato procedura dhe tani kemi raportin mbi diskutimin publik i cili përmban të gjitha çështjet e ngritura dhe arsyetimet e nevojshme, e që në fakt duhet t'i nënshtrohet votimit në mënyrë që nëse miratohet pastaj është procedurale spastrimi i tekstit, përkatësisht inkorporimi i propozimeve, sugjerimeve apo plotësimeve, prandaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e vë në votim duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 19 vota për, asnjë votë kundër, dhe 8 vota të përmbajtura (të tjerët nuk kanë votuar apo nuk kanë qenë në sallë gjatë votimit) miratohet raporti mbi diskutimin publik përkatësisht miratohet Strategjia për Zhvillimin e Turizmit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

4. Raporti dhe rekomandimi i Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, jeni në dijeni që ekziston një komision i themeluar nga ky Kuvend, i cili sigurisht që jeni në dijeni se është funksional sa i përket ndarjes së shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve – Balloc. Përzgjedhja e fundit për 20 shtëpi, ashtu sikurse herave tjera, është bërë ashtu siç parashihet me Rregullore sipas të cilës përcaktohen kushtet, kriteret dhe shfrytëzimin e shtëpive në pronësi të Komunës, dhe çështje tjera, të cilat përfshihen në kuadër të Kontratës e cila lidhet mes organit kompetent të Komunës dhe përfituesit/shfrytëzuesit të përkohshëm të shtëpisë. Ndër të tjera ne kemi një rekomandim nga Komisioni që kryesisht lidhet me dy pika kryesore, dhe atë, përcaktimi i shumës së qirasë vjetore që është e caktuar në Rregulloren përkatëse të Kuvendit të Komunës, pastaj në Ligjin për financimin e programeve të banimit dhe Udhëzimit Administrative përkatës sipas të cilit përcakton qiranë joprofitabile.

Unë me këtë rast deshta të përcjellë këtij Kuvendi rekomandimin e komisionit përkatës, sipas të cilit komisioni ka paraparë që edhe përkundër asaj që Ligji i cekur e përcakton qartë kuotën e qirasë së banimit për shtëpi të tilla të banimit, rekomandimi është që çmimi për shfrytëzimin e këtyre shtëpive (e që deri tani janë rreth 90 shtëpi të tilla) të jetë zero euro, kjo për shkak të situatës së tyre sociale – ekonomike gjë për të cilën besoj që shumica jemi në dijeni për statusin e tyre social, por që përcaktimi i një qiraje mujore dhe vjetore do të ishte ngarkesë e madhe për ato familje, si dhe fakti tjetër që ne si Komunë por edhe në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm vazhdimisht japim subvencione të ndryshme atyre familjeve me qëllim që të mbahen sa i përket jetës së tyre sociale, pavarësisht që statusin e tyre social deri më tani nuk kemi mund ta ndryshojmë në masë të madhe, andaj edhe rekomandim i komisionit është çmimi i qirasë të jetë zero euro, por mbetet që ju si Kuvend ta vlerësoni këtë pa përjashtuar edhe çështje tjera që janë potencuar në rekomandim në mënyrë që vendimi për këtë çështje të jetë sa më unifikues, por ta kemi që kjo qarta që kuota më e lartë e qirasë, sipas ligjit është 4% e investimeve në ndërtimin e objektit përkatës, kuota më e ultë nuk është përcaktuar, ndoshta mund të parashihet një shumë simbolike, por ta kemi për bazë se çdo shumë e cila paraqitet mendoj se kish me qenë sepse kjo konsiderohet si qira joprofitabile e cila pastaj ndoshta do të nxirrte edhe çështje tjera të cilat do ta kishim të vështirë të menaxhonim pastaj. Dëshiroj të tregoj vetëm një detaj, në ligjin e cekur sipas të cilit përcaktohet qiraja thuhet, me çmimin e qirasë shfrytëzuesit e shtëpive do të kenë mundësi të marrin shërbime të caktuara në kuptimin e mirëmbajtjes së objektit, për të qartësuar, në të ardhmen në rast të problemeve me ndonjë derë, dritare etj, do të kërkojnë t’iu blihet e re ose varësisht problemeve të rregullohet, që në fakt mbetet obligim i Komunës. Pavarësisht kësaj unë mendoj që është mirë të përfillet rekomandimi i komisionit dhe të shkohet me qira zero euro. Pastaj është edhe pika tjetër e rekomandimit që ka të bëjë me kohëzgjatjen e shfrytëzimit të atyre shtëpive, çështje e cila duhet të përcaktohet me kontratë. E që unë mendoj dhe absolut e arsyetoj rekomandimin e komisionit që shfrytëzimi të jetë afatgjatë, pa përcaktim, por deri në ndryshimin e statusit social-ekonomik të tyre, përkatësisht deri në një vendim tjetër.

z.Agim Behluli, në emër të kryesuesit të komisionit, theksoi, ne si komision jemi munduar maksimalisht të bëjmë një punë të mirë por normal që në atë Lagje mund të ketë edhe të pakënaqur ngase kanë qenë për ti ndarë vetëm 20 shtëpi kurse kanë qenë 40 kërkesa. Përfitues nga kjo ndarje e këtyre 20 shtëpive janë: Shaip Zeqiri, Nazmije Dudi, Selvije Fejzullahu, Islam Berisha, Luljeta Murtezi, Naim Aliu, Hafize Sherifi, Florim Havolli, Behxhet Osmani, Ejup Hasani, Avdullah

Bogujevci, Shaban Kodraliu, Rrahim Fejzullahu, Skender Gimolli, Hamdi Qerimi, Hazir Rekalio, Ilaz Veseli, Ramdan Potoku, Bahtir Zeqiri dhe Isuf Rama.

Kemi të bëjmë me familje të Invalidëve, Dëshmorëve, Veteranëve të luftës, dhe atyre raste sociale. Propozim i yni ka qenë që aty familje të mos paguajnë qiranë e banimit, dhe personalisht qëndrojnë prapa kësaj, si dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të jetë pa afat. Kemi të bëjmë me familje të cilat tani e 20 vite qëndrojnë në atë Lagje. Janë edhe 20 familje të cilat kanë mbetur në kontejner, pa u sistemuar në këtë program, andaj lus të gjithë që të gjenden mundësi për ndërtimin e shtëpive dhe të zhvendosen nga ata kontejner dhe njëkohësisht t'iu rregullohet statusi i tyre social.

Në atë Lagje ka familje të cilat ndoshta edhe nuk e meritojnë të jenë aty, por kjo është çështje tjetër e cila mund të zgjidhet përmes një komisioni të këtij Kuvendi që do të mund të ngritej për verifikimin, vlerësimin dhe vërtetimin e gjendjes së tyre ngase deri në vitin e kaluar kanë qenë 50 shtëpi që janë ndarë, në vitin e kaluar janë ndarë 20 shtëpi tjera, këtë vit siç e ceka janë në proces të ndarjes edhe 20 shtëpi tjera, e që mund të them se deri në një masë ato familje që kanë hyrë në shtëpi të reja janë shumë të lumtur. Pra kjo ishte në pika të shkurtra, kurse për çështje tjera të nevojshme që mund të ketë interesim, mund të japim përgjigje ose sqarime të nevojshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, përgëzoj komisionin për punën e bërë rreth ndarjes së shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjova parafolësit të cilët japën sqarimet dhe arsyetimet rreth ndarjes së shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, që të dy parafolësit janë nga radhët e subjektit LDK. Është e vërtetë se është stërgjatë projekti i banimit të veçantë në Lagjen e Dëshmorëve. Pati një kërkesë nga drejtori i DSHMS jo të specifikuar mirë, për propozimin e qirasë qoftë edhe 1 €, mirëpo kur të jepni propozim i nderuar drejtor duhet të ketë bazë ligjore, e jo vetëm të thuhet në bazë të asaj çfarë jua merr mendja juve. Të gjithë jemi që ti lirojmë nga qiraja e banimit ato familje, mirëpo jeni drejtor i DSHMS, pozitivë e cila ka për obligim në bazë të legjislacionit në fuqi, me të gjitha kapacitetet intelektuale dhe financiare me ju dhënë përgjigje qytetarëve të Komunës së Podujevës të cilët i përkasin kësaj kategorie. Si drejtor që jeni, sigurisht jeni në dijeni se Ligji nr.03/L-164, neni 9 pika 4 e specifikon shumë mirë këtë pikë, ju jeni drejtor ekzekutiv kurse komisioni i cekur është komision dhe mund të propozoj dhe rekomandoj çdo gjë, madje kryetari i komisionit kishte nxjerrë vendime ai vetë rreth 70 të tillë, mirëpo nuk ia miratoj unë këtu si Kuvend ngase ato shtëpi nuk janë pronë private por është institucion, andaj komisioni është ngritur për vlerësimin e gjendjes, ndarjen e shtëpive etj. të ngjashme, kurse Kuvendi është ai i cili mbikëqyrë se si janë ndarë ato shtëpi, a janë ndarë mbi bazën e drejtësisë apo si janë ndarë dhe tani ky Ligj për financimin e programeve të veçanta të banimit thotë që qiraja e banimit të këtyre kategorive nuk mund të jetë më e madhe se 4% e koston së ndërtimit të objektit në bazën vjetore apo më e madhe se 0.04% e koston së vlerës së tregut, kosto të cilën duhet të nxjerrin ju drejtor dhe të përgatitni gjithë lëndën dhe të sqaroni gjithë këtë çështje por që nuk jeni marrë me këtë fare, vetëm keni marrë rekomandimin e komisionit vlerësues, të njëjtin e keni proceduar në KPF dhe tani jemi duke u marrë edhe në Kuvend. Pyetje drejtorit të DSHMS-së, nëse sot Kuvendi miraton qira mujore të banimit në lagjen e cekur, sa është kostoja mujore e një familjeje në atë lagje.

Çështja tjetër, unë kam pas besim të plotë tek kryesuesi i komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, por që është i papranueshëm veprimi i tij duke lëshuar vendime, për çka mund të themi se është një gafë nga ana juaj i nderuar edhe pse tani gjitha ato vendime janë të anuluar, është një gabim i madh ky dhe në raste të tilla duhet të kemi kujdes, prandaj jam skeptik që në komisione tjera a ti jap mbështetjen apo jo këshilltarit të cekur të jetë pjesë e tyre.

I nderuar drejtor, çka e rrezikon pjesën tjetër të mbetur që nëse nuk gaboju janë, edhe 20 familje që kanë mbetur ende në kontejner banimi, deri më datën 22 të këtij muaji, ju si drejtor i DSHMS nuk e ke

mbikëqyr atë vend, do të humbni 120,000.00€ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - MPMS, prandaj si e arsyetoni punën e juaj ngase është kryer tenderimi, janë kryer të gjitha procedurat administrative kurse nuk ka filluar puna fare, çfarë përgjigje mund të keni ku humbi këtë shumë të mjeteve buxhetore ku të gjitha ato shtëpi kryhen për të gjithë banorët e lagjes. Të keni pozitën drejtor dhe të emëroheni nga dikush për interes të tij personal dhe ti zëni vendin dikujt që është shumë më profesionist se ti është e lehtë kjo sepse je drejtor i dëgjueshëm i dikujt mirëpo profesionalizmi i kësaj Drejtorie aspak nuk ka të bëjë me punën dhe detyrat që i përcakton ligji dhe pozita zyrtare e juaja, aspak nuk keni qenë bashkëpunues dhe mbikëqyrës me komisionin, aspak nuk keni marrë hapë që të kryeni punën e juaj me nivelin qendrorë përkatësisht me MPMS e cila ka ndarë mjetet buxhetore të cilat po humbin ku do të kryheshin të gjitha shtëpitë, aspak nuk jeni në ngjarje të punëve në atë lagje dhe aspak nuk keni përgjigje për propozimin e juaj 1 € qira mujore të banimit, nëse keni bazë për këtë propozim dil në foltore dhe sqaroheni bazën, nëse nuk keni më mirë është të qëndroni në vend, të merren ato familje të vendosen në shtëpi të reja ngase janë vendos edhe 50 familje tjera në të kaluarën pa pasur kontratë, të rregulloni dokumentet ose të lironi vendin për dikë që vie dhe i kryen punët administrative në vitin 2020.

z.Agim Behluli, theksoi, më vie keq i nderuar këshilltar z.Rafet Llapashtica, por nuk jeni mirë i informuar, unë i kam nënshkruar 20 vendime e jo 70 siç e cekët ju, në emër të komisionit janë lëshuar ato vendime dhe unë i kam nënshkruar si kryesues. Ne si komision jemi munduar të bëjmë punën më të mirë të mundshme, kurse kush dëshiron ta provoj ndryshe urdhëroni. Pra i kam nënshkruar 20 vendime për të cilat ndihem krenarë që jemi munduar të kryejmë atë punë.

Ne jemi munduar të bëjmë më të mirën të mundshme, ndërsa kujt nuk i pëlqen urdhëroni shkoni provojeni, por ajo Lagje dhe ato familje janë aty qe 20 vite, dhe ne jemi munduar që ato familje ti heqim nga ata kontejner, madje sa për informim unë personalisht kam paguar euro edhe nga xhepi vetëm e vetëm që ato familje të sistemohen në shtëpi të reja, madje edhe ujin dhe rrymën ka raste që jua kam paguar vetë që ato familje të hiqen nga kontejnerët. Pra është vepruar për tu kryer puna, ndërsa ju që keni qenë edhe më përpara këtu në Kuvend i keni lanë në kontejnerë ato familje, jo unë, ju i nderuar Rafet i keni lënë ashtu siç janë, madje jeni thirr në atë se ju janë djegur shtëpitë në luftë, mirëpo oborret nuk ju janë djegur atyre prandaj pse nuk i keni ndërtuar nëpër oborret e secilit por keni bërë lagje për interesa të dikujt, e di këtë sepse edhe më 1999/2000 këndeje kam qenë dhe e di edhe personin i cili tash më nuk është gjallë përse e ka bërë atë lagje (mahall).

Ligji është për të gjithë, jemi munduar të zbatojmë pa kurrfarë përfitimesh, por jemi munduar të bëjmë më të mirën ndërsa nëse ndokush ka ndonjë vërejtje lirshëm mund të merrni fjalën dhe të thuani, ose mund edhe të shkojmë kështu siç jemi në atë lagje të shikojmë gjendjen reale.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e kuptoj plotësisht parafolësin z.Agim Behluli, por unë bisedoj ndryshe, madje e i cekë edhe emrat pavarësisht që mund të mos jenë në jetë. Këshilltari në fjalë e tha, Ju, duke mu drejtuar mua, unë pak më parë e thash që keni nënshkruar 70 vendime, ju e thatë që vetëm 20 i kam nënshkruar, kurse unë ju pyeta a keni nënshkruar vetëm 1, ti the po i kam 20 vendime të nënshkuara.

Çështja tjetër, qe 20 vite ekziston Drejtorja e cila merret me mirëqenie sociale, andaj mos e thuaj ju, por thuaje ne, sepse ju keni qenë në pushtet. Po ta them në emrin tim personal që atë problem në atë lagje, jo për 1 mandat por për 1 vit do ta përfundoja, por është besimi i qytetarëve që ju ka dhënë dhe qe ku ju kanë urdhëroni punoni, nuk jam kundër. Çdo proces legjitim ligjor e kam respektuar dhe e respektoj, mirëpo jeni propozuar ju për anëtarë respektivisht për kryesues i komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, keni marrë miratimin e gjithë Kuvendit, kurse keni lëshuar vendime, çfarë të bëjmë tash. Pastaj keni drejtorin e juaj të DSHMS kompetent i cili nuk po ka përgjigje për disa çështje që i shtrova, ndërsa ju thoni kam paguar rrym e ujë, kurse unë po them keni

humbur 120,000.00€ nga MPMS të cilat nga 22 dhjetori i kthehen nivelit qendrorë, madje madje në vitin e kaluar keni kthyer rreth 2 milion e gjysmë si suficid dhe nuk keni qenë në gjendje të filloni ndërtimin e atyre shtëpive. Pra ti këshilltar i nderuar (i drejtohet Agim Behlulit) keni bërë vetëm një gabim, keni nënshkruar vendime që t'iu ndahen shtëpitë familjeve përkatëse, mirëpo ju them që ato familje pa drejto e me drejtor, pa ju ose me jo qe 20 vite qëndrojnë aty dhe nuk ka askush që mund t'iu ndal as nuk do të mund ti ndal.

z.Fatmir Rudari, theksoi, unë si anëtar i komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, mund të them se si komision që jemi kemi bërë punën më të mirë të mundshme, mirëpo ditëve të fundit kemi ardh deri tek një dilemë rreth pagesës së qirasë së banimit për familjet e sistemuara në atë lagje. Do të thotë ne si komision i kemi rekomanduar Kuvendit që të mos ketë pagesë të qirasë, mirëpo në ligjin përkatës ceket se duhet të jetë një qira, gjë për të cilën besoj që edhe zyra ligjore mund të na ndihmoj në këtë aspekt, andaj nuk po e kam që qartë se ne si Kuvend a kemi të drejtë të marrim vendim duke hequr qiranë për ato familje, apo mund të vazhdojmë të marrim vendim me një qira simbolike për çka lus zyrën ligjore të na ndihmojnë pasi që sipas ligjit Kuvendi për çdo vit duhet të merr vendim dhe të caktoj shumën e qirasë së banimit dhe kohëzgjatjes së shfrytëzimit, mirëpo në gjëra tjera nuk do të doja të lëshohemi ngase si komision jemi munduar të bëjmë punën më të mirë të mundshme, pa përjashtuar ndonjë gabim eventual që kemi mund të bëjmë tash së fundmi për shkak të gjendjes së tyre sociale dhe për shkak të përshpejtimit të kohës për ndarjen dhe sistemimin e familjeve përfituese me qëllim të vendosjes sa më shpejt në shtëpitë e ndërtuara.

Edhe njëherë lus zyrën ligjore të na jap sqarim se a mundemi edhe këtë vit ndajmë pa pagesë ato shtëpi dhe të marrim vendim ne si Kuvend apo në çfarë forme të veprojmë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sa i përket kësaj teme besoj që ky propozim vendim përkatësisht ky rekomandim duhet të kaloj, në rast se pagesa nuk është në harmoni me dispozitat e ligjit përkatës, atëherë vlefshmërinë e çdo akti e bënë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ose Ministria përkatëse varësisht fushës së aktit. Gjykoj se edhe ligjet tjera të caktuara siç është ai për invalid dhe familje të Dëshmorëve e rregullojnë shumë mirë këtë materie, prandaj e them se është mirë ta miratojmë një vendim të tillë pastaj janë Ministrinë përkatëse që japin vlerësimin ligjor përkatësisht i japin efektin e ligjshmërisë së aktit. Ky problem mund të themi se është i përgjithshëm dhe nëse tani ne merremi me historik të kësaj çështje besoj se nuk është mirë nga asnjë subjekt apo grup politik të lëshohemi në popullizëm apo për përfitime të votave. Gjendja në atë lagje dhe ato rrethana nuk është e mirë dhe ata qytetarë presin nga ne që ne t'iu bëjmë zgjidhje.

z.Vendenis Lahu, theksoi, edhe unë si anëtar i komisionit përkatës dola ta them fjalën time ndoshta ndihmoj paksa në sqarimin e situatës. Ne si anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe si anëtarë të komisionit për ndarjen e shtëpive kemi bërë përzgjedhjen e përfituesve në këtë fazë, që kanë qenë gjithsej 20 shtëpi. Besoj se këtë mandat e kemi pasë dhe e kemi kryer me bindje të plotë, por ajo që ne nuk kemi qenë plotësisht të bindur dhe që ndoshta presim edhe interpretim ligjor është ligjshmëria e pagesës së qirasë që u diskutua deri tani dhe që është përcaktuar prej neve si komision, gjë për të cilën zyra ligjore neve na ka rekomanduar që ne ta përcaktojmë sepse siç kanë thënë ata me ligj është e përcaktuar se kjo është kompetencë e komisioneve e jo e DSHMS. Ne nuk jemi jurist dhe nuk e dimë si rregullohet kjo çështje andaj kjo është ajo që ne kërkojmë nga juristët e sidomos nga zyra ligjore që të na përcaktoj qartë se kompetencë e kujt është. Në fakt ne si komision kemi rekomanduar që të mos ketë qira fare dhe kohëzgjatja të jetë afatgjate për shkak se 20 përfituesit e fundit ende nuk janë futur nëpër shtëpitë e ndërtuara për shkak se zyra ligjore siç na ka thënë duhet t'iu jepen kontratat përfituesve, si dhe duhet bërë një rekomandim nga komisioni, dhe barrën na e ka dhënë neve si Komision, ne kemi bërë rekomandimin dhe të njëjtin e kemi paraqitur këtu para juve,

por si do që të jetë kjo ndoshta është më shumë në kompetencë të zyrës ligjore, ndërsa nëse është e jona ne kemi dhënë rekomandimin si komision, në të kundërtën, MAPL me rastin e vlerësimit do ta kthej si të pa bazuar këtë vendim, kështu që mendoj se ajo që ne kemi dhënë në rekomandim është e arsyeshme kurse për ligje është zyra ligjore dhe ne nuk kemi njohuri.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, pyetje komisioni, propozimi i komisionit për ndarjen e shtëpive, mendoj se do të duhej të jetë më decidiv sepse jemi institucion dhe pastaj të diskutojmë pa nevojë.

Çdo vit Kuvendi i Komunës duhet të merr një vendim për këto kategori përkatësisht për qiranë sepse ashtu parashihet me ligj, ndërsa kontrata, format e lirimeve, pagesave të shfrytëzimeve, Ekzekutivi i Komunës i bënë, dhe i nderuari Kryesues i Kuvendit, ju kuptoj se jeni në subjektin politik që jeni, por kontratë me ata shfrytëzues të shtëpive lidh Ekzekutivi i Komunës, mund të vëni çfarëdo qiraje zero euro, ose sa të dëshironi qoftë edhe 1 euro, por me atë qira Komuna merr obligim që qoftë edhe një dritare nëse dëmtohet duhet ta ndërroj, sipas ligjit. Po e llogaritim që 1 euro në vit të jetë qiraja për secilën familje, e që e kanë mundësinë e pagesës, mirëpo ka kategori kush dhe si lirohet, kategoritë e dala nga lufta janë të liruara nga taksat, tatimet dhe prej çdo shërbimi institucional shtetërorë si dhe janë të liruara kategoritë e familjeve me asistencë sociale që iu jepet ndihma prej 70€, pra është ligji sipas të cilit lirohen nga këto shërbime, kurse drejtori i DSHMS e thotë se kemi rekomandim nga komisioni, kurse komisioni po thotë se nuk jemi bash të sigurte në këtë çështje dhe i kemi thënë drejtorit shkoni në zyrën ligjore merrni mendimin se si të veprohet në bazë të ligjit, kurse nuk ka marr përgjigje ligjore as nga zyra ligjore.

Pyetje konkrete, a jeni për zbatimin e ligjit përkatës i nderuar drejtor i DSHMS apo jo, nëse po urdhëroni merrni fjalën dhe deklarohuni, nëse jo atëherë mos bëni propozime me rekomandime si në oda.

z.Hasan Ajeti, theksoi, fillimisht këshilltari z.Rafet Llapashtica po jep brenda një artikulimi apo qëndrimi politik për një temë të caktuar dy qëndrime, një të pro, tjetër të kundër.

Në rast se thuhet që këto apo ato kategori janë të liruara, pa dashur të nënkuptohet që dola për të vlerësuar aftësitë profesionale në fushën që je, por jeni në dijeni shumë mirë se ka kolizion të ligjeve në disa fusha, mirëpo janë ligjet e caktuara apo të veçanta të cilat rregullojnë çështjet e tilla.

Për të ardhur në përfundim rreth vlefshmërisë së këtij akti që ne mund ta miratojmë sot, është Ministria përkatëse e cila e bënë vlerësimin qoftë për qiranë qoftë për kohëzgjatjen e shfrytëzimit qoftë për çështje tjera, askush tjetër as zyra ligjore as askush tjetër madje nuk keni nevojë fare t'i referoheni zyrës ligjore të Komunës me kërkesë për interpretim për një çështje të tillë, prandaj nuk kemi çka të diskutojmë më gjatë për këtë temë sepse sa të vazhdojmë më tutje vetëm mund të kthehemi mbrapa në historik, andaj të vendosim pastaj nëse kthehet jo ligjore ulemi e diskutojmë dhe veprojmë në bazë të rekomandimeve të Ministrisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se diskutimi përfundoj. Sa kuptova propozim ishte që rekomandimi i komisionit të cekur të hedhet në votim dhe nëse i njëjti miratohet pastaj spastrohet, përkatësisht kthehet në vendim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se njëzëri, me vendim miratohet rekomandimi i komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, sipas materialit përkatës të dërguar dhe rekomandimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

5. Të ndryshme

znj. Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së kemi një kërkesë nga ana e prindërve që i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollën “Xheladin Rekalii” që urgjentisht të zgjerohet rruga sepse ka vend për zgjerim ku aty afër është ish Fapol pronë e Komunës, kërkesë e cila është bërë edhe në mandatin e kaluar.

Kërkesa tjetër është, përse Rregullorja për përcaktimin e orarit të punës në Komunën e Podujevës, edhe pse ka kaluar në debatin publik nuk është sjellë për miratim.

Dhe kërkesa tjetër është, përse QKMF-ja tash e sa kohë nuk ka pediatër, kur dihen nevojat dhe kërkesat për pediatër.

z. Mirsad Kamerolli, drejtor i DPZHE, përgjigje parafolëses në pyetjen e dytë, theksoi, si zakonisht punët e mrekullueshme që i bënë Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ne kemi përgatitur dhe paraqitur edhe draftin e rregullores në fjalë, si propozim final, e kemi paraqitur në diskutim publik ku kemi bërë një kohezion me të gjitha grupet e interesit pothuajse të fushave të ndryshme që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës dhe besoj se shumë shpejt do të sjellët për miratim final në Kuvend ku me siguri se nuk do të ketë asnjë pakënaqësi.

z. Fatmir Rudari, theksoi, është hera e tretë ose e katërt kjo që paraqesim një kërkesë për ngritjen e një komisioni për shqyrtimin e ankesa për emërtimin e rrugëve në Komunën e Podujevës, dhe nuk po marrim përgjigje. Sa kemi informata janë mbi 100 ankesa të bëra lidhur me emërtimin e rrugëve dhe nuk ka kush t’i shqyrtoj, andaj ne si Kuvend besoj se mund ta ngrisim një komision i cili do të mund t’i shqyrtonte ato ankesa.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjen e ngritur nga parafolësi, sa kam vërejtur legjislacionin, është një kohëzgjatje rreth 5 vite deri sa t’i skadoj afati komisionit që është marrë me këtë punë, dhe Drejtoria përkatëse duhet të merret me këto çështje, mirëpo nëse bëjmë komision konsideroj se bëjmë shkelje, por është Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e cila duhet t’i marrë kërkesat/ankesa dhe t’i shqyrtoj. Pra është në kompetencë të Drejtorisë kjo çështje, përndryshe mund të kërkohet nga kjo Drejtori të jap përgjigje rreth ankesave në fjalë.

z. Vendenis Lahu, theksoi, arsimi është një dikaster i rëndësishëm i jetës edukativo-arsimore por edhe i zhvillimit të shtetit besoj. Para pak ditëve kanë dalë rezultatet e një testi ndërkombëtar që është bërë (testi Pisa), rezultate të cilat kanë dal si mos më keq dhe jemi në fund të listës së bashku me Republikën Domenikane dhe atë të Filipineve. Ajo që dua të them është se edhe niveli lokal luan rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe këto rezultatet skandaloze të Pisa-s janë si pasoj e një sistemi arsimor jo të mirë, por jo vetëm pasoj e një sistemi arsimor jo të mirë por edhe si pasoj e mos maksimalizimit të arritshmërisë brenda këtij sistemi sa do jo i mirë që të jetë, prandaj meqë edhe niveli lokal luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, unë kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dhe atë, i nderuar drejtor cili është plani i Drejtorisë dhe i juaji si drejtor, a do të ndërmarrësh diçka për të përmirësuar gjendjen të paktën në Komunën tonë. E them këtë sepse besoj se ka shumë mundësi, shembull, në orët e historisë mësojnë nxënësit Perandorinë Romake pa një hartë dhe nuk ja kanë idenë për çka po flasin, ku shtrihet etj, dhe pa dyshim këto janë procese të cilat dërgojnë në rezultate të tilla, prandaj cilat janë planet tuaja dhe a keni për të ndërmarr diçka dhe hapat që do të ndërmerrni në këtë aspekt, nëse po cilat janë hapat dhe proceduarat që do të ndërmerrni.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, përgjigje në pyetjen e këshilltares znj. Adelinë Stublla, theksoi, rruga në drejtim të shkollës “Xheladin Rekalii” ka qenë në një gjendje të rënduar dhe nuk ka mund të rregullohet për shkak të

punimeve në zgjerimin dhe rregullimin e lumit Llap sepse nuk ka pasur rrugë dhe mundësi tjera. Para disa ditëve ajo rrugë është ri asfaltuar por që vërtetë është paksa e ngushtë e që ka dy mundësi që të rregullohet, ose të ndërhyhet në trotualet që janë ose të bëhet zgjerimi i asaj rruge e që jemi duke analizuar me Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë për mundësitë pronësore të zgjerimit të rrugës në fjalë. Ende nuk jam në dijeni se si do të veprohet por problemi emergjent në atë rrugë është evituar mirëpo besoj se krahas rrugës “Zahir Pajaziti” do të shkojmë me zgjerim dhe ndriçim të rrugës në fjalë.

znj.Floretë Zejnullahu, theksoi, meqë Komisioni Qendrorë Zgjedhor ka bërë certifikimin e zgjedhjeve të datës 06 tetor 2019 dhe pritet thirrja e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, me gjasë kjo do të jetë seanca ime e fundit si këshilltare e Kuvendit të Komunës së Podujevës, por që me kohë do të paraqesë edhe dorëheqjen time ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi.

Për fund do të doja të jepje edhe një propozim, meqë pritet të formohet edhe komisioni i ankesave në procesin e emërimit të rrugëve në Komunën e Podujevës, do të doja të lë një propozim i cili besoj se na takon edhe neve si Kuvend, si Komunë, si këshilltarë komunal që të iniciojmë procedurën e emërimit të një rruge apo ndonjë sheshi me emrat e dy ikonave të Llapit, legjendës së futbollit kosovar Fadil Vokrri, dhe rezistencën tonë Kombëtare Adem Demaçi.

Është turp i madh për neve si Komunë që të mos kemi ndonjë rrugë apo shesh me emrin e këtyre dy legjendave me të cilët krenohemi jo vetëm ne si Llap por i gjithë Kombi Shqiptarë, dhe ta të cilët i njih bota dhe që kanë lënë gjurmë në historinë tonë të paktën duhet të jenë të nderuar në vendlindjen e tyre së pari.

Me shpresë se kërkesa ime do të realizohet, Ju uroj shumë fat, suksese dhe shëndete për të gjithë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në emrin tim personal dhe në emër të Kuvendit të Komunës, i urojmë znj.Floretë Zejnullahu mandatin e Deputetes së Kuvendit të Kosovës, dhe gjithë atyre që mund të kenë marr votat e mjaftueshme për deputet, duke uruar shëndet, suksese dhe përfaqësim sa më të mirë të trevës së Llapit në organin më të lartë shtetëror të Republikës së Kosovës.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, dëshiroj të japë disa përgjigje lidhur me disa prej pyetjeve të parashtruara në fillim të mbledhjes nga këshilltari i Kuvendit z.Arbër Blaku, lidhur me atë çfarë ka bërë Komuna si përgjigje ndaj shkatërrimeve dhe humbjeve të shumë jetëve nga tërmeti në Shqipëri. Qysh në mëngjes të asaj dite ne menjëherë kemi kontaktuar me Komandantin e Stacionit të Policisë në Podujevë i cili ka ardh në Komunë, pastaj jemi takuar me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për të marrë informata rreth pasojave eventuale në Kosovë e që fatmirësisht në Komunën e Podujevës nuk ka pas pasoja. Mandej Kryetari i Komunës menjëherë ka thirr Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim i cili përbëhet prej shumë akterëve, takim ku janë shkëmbyer informacione dhe është raportuar për gjendjen në Komunën e Podujevës.

Pas pak kohe me urgjencë është thirr edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, mbledhje në të cilën është raportuar nga Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe nga përfaqësuesit e KFOR, për gjendjen e përgjithshme të sigurisë, me theks pas tërmetit në Shqipëri e që nëse mund të them pas atij reagimi emocional që kemi pasë si shoqëri e që është i kuptueshëm si përgjigje ndaj tërmetit në Shqipëri.

Jemi në dijeni se menjëherë e gjithë Kosova është mobilizuar, në një formë edhe shoqëritë civile dhe institucionet tjera siç janë Policia e Kosovës dhe FSK për t'i dalë në ndihmë Popullit të Shqipërisë, e që edhe në Podujevë kështu pothuajse ka qenë gjendja, janë organizuar shoqata të ndryshme, aktivistë të ndryshëm, janë grumbulluar ndihma dhe të njëjtat janë dërguar në Shqipëri edhe pse në bazë të informatave që kemi kur kanë shkuar atje pak më ndryshe ka qenë situata jo ashtu siç kemi

menduar ne, mirëpo është e kuptueshme që ne kemi reaguuar edhe në mënyrë emocionale sepse në këto rastet është e kuptueshme të reagohet në atë mënyrë.

Sa i përket pyetjes së këshilltarit të cekur rreth mundësisë së ndarjes së një buxheti si ndihmë nga Komuna e Podujevës, jemi në dijeni se janë 2-3 Komuna të cilat kanë ndarë buxhet për këtë çështje, edhe pse unë personalisht mendoj se nuk do duhej që në këtë formë, por si Shtet i Kosovës si Qeveri të ndan mjetet buxhetore për t'iu përgjigj fenomeneve të padëshiruara natyrore siç ishte tërmeti në Shqipëri, dua të them se do të ishte shumë më lehtë se sa kjo ku Komunitat në një formë të bëjnë tani "gara" se kush më shumë e kush më pak po ndan mjete buxhetore, kush po është më patriot, cila Komunë, cili Kryetar Komune, prandaj e them se ndoshta Qeveria do t'ishte dashtë që menjëherë të ulej dhe të ndan buxhet ndoshta në këtë rast edhe shuma milionëshe, e jo të ndahen shuma 10.000.00€ - 20,000.00€, por si do që të jetë, ne kemi biseduar dhe Kryetari i Komunës është i disponimit që nëse Ju vendosni dhe mendoni që edhe Komuna e Podujevës duhet të ndaj ndonjë shumë të caktuar buxhetore si ndihmë. Nga raportet zyrtare që i kemi qoftë nga Policia qoftë nga të tjerët, e që vlen të përmendet se pas dy ditëve unë kam pasë një takim në Stacionin e Policisë në Podujevë ku prezent kanë qenë edhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Policisë, ne duhet të jemi pak më syçelë sepse tani veç ka filluar që kjo krizë në Shqipëri të keqpërdoret në një masë të madhe nga ana e qytetarëve të Shqipërisë të ardhur në Kosovë, kanë hyrë njerëz edhe me precedentë penale, fatkeqësisht janë konfiskuar edhe substanca narkotike që kanë hyrë kënde sepse kur hapet kufiri pastaj mund të hyjnë gjithçka dhe sigurisht që ka hyrë gjithçka e që ndoshta ne si shtet nuk kemi qenë shumë të organizuar që në hyrje të kufirit të marrim evidencë për të gjithë qytetarët që kanë hyrë në Kosovë dhe të verifikoheshin ato lista prej cilit territor apo vendbanim të Shqipërisë. Sipas burimeve të informacionit të marra nga Policia, në Podujevë kemi pasë qytetarë të Pogradecit të cilët kanë ardhur dhe me veturë natën janë ndaluar ku përgjigja e tyre ka qenë kinse po kërkojnë banim ose strehim, pastaj pas kontroleve të dokumentacionit të tyre ata kanë qenë të rinj dhe pa familje që kanë ardhur nga Pogradeci, vend ky që fare nuk është prekur nga tërmeti. Po dua të them se kjo nuk duhet t'i jap hije të keqe gjithë atij angazhimi qytetarë dhe institucional që ka pasë Kosova në këtë situatë, por megjithatë ne nuk duhet të jemi aq shumë euforik, por duhet të jemi shumë më të organizuar dhe të sistemuar në mënyrë që të jemi në dijeni sakt për ndihmat e qytetarëve tanë sepse këto janë mjetet të taksapaguesve të qytetarëve të Kosovës, ku dhe si po i dërgojmë.

Nëse ju mendoni dhe vlerësoni, për çfarëdo shume të mjeteve buxhetore që mund të ketë kapacitet Komuna e Podujevës të ndahet si ndihmë për Shqipërinë, ne jemi të gatshëm, dhe nëse ndokush mendon se jemi vonuar, nuk qëndron ajo sepse nuk jemi vonuar sepse ato që janë ndarë deri tani kanë qenë ndihma emergjente me ushqime dhe veshmbathje, kurse ndihmat e mëdha priten të vlerësohen kapacitetet e Komunave dhe ai i Shtetit të Kosovës se çfarë do të jenë ato ndihma financiare për Qeverinë e Shqipërisë e cila pastaj do t'i shpenzoj për strehim, për ndërtim të objekteve të banimit apo për infrastrukturën e shkatërruar. Pra kjo ishte ajo çfarë mund t'ju them rreth pyetjes së parashtruar.

z.Avni Fetahu, theksoi, kemi një kërkesë jashtë asaj çka u diskutua këtu. Duke marrë parasysh se salla e mbledhjeve të Kuvendit në objektin e ri të Komunës ishte rregulluar, do të donim që në seancat e radhës të zhvendosemi atje, edhe për shkak të kushteve më të mira por edhe për shkak të të ftohtit këtu ë jemi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, të gjithë mezi nuk po presim të zhvendosemi në objektin e ri të Komunës, andaj në momentin që salla të jetë gati, ne do të thërrasim mbledhjet në objektin e ri të Komunës.

z.Arbër Blaku, theksoi, falënderoj Nënkryetarin e Komunës për informata dhe sqarimet e bëra rreth çështjes në fjalë, përkatësisht lidhur me gjendjen e krijuar në qytetin tonë, mirëpo sa për informatë Qeveria ka ndarë një shumë prej 500,000.00€ si ndihmë për Shqipërinë pas tërmetit që ka ndodh atje. Sa i përket asaj që ne si Kuvend të vendosim, konsideroj se nuk mund ta propozojmë shumë që Komuna duhet të ndaj për ndihmë Shqipërisë, mirëpo Kryetari i Komunës duhet të sjellë një propozim konkret kurse ne si Kuvend të vendosim, qoftë një shumë prej 1,000.00€ apo 100,000.00€ varësisht mundësive tona si Komunë, pastaj ne jemi në gjendje të miratojmë, madje qoftë edhe ndonjë mbledhje urgjente apo të jashtëzakonshme.

Dëshiroj të them se nuk mundemi ne të caktojmë shuma buxhetore sepse pastaj hapet temë ndoshta e patriotizmit, por sjellni ju propozimin, thirrreni seancën dhe ne e miratojmë.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe ne si LVV e mbështesim çdo iniciativë që merret qoftë nga ana e Kryetarit të Komunës, qoftë nga Kuvendi i Komunës që t'iu dalim në ndihmë vëllezërve tanë sepse jemi në dijeni se dëmet janë të mëdha dhe nevojat janë të mëdha atje, kurse tani është faza e ndërtimit të objekteve të shkatërruara.

Propozim konkret kemi që mjetet e planifikuara për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, të destinohen për ndërtimin e shtëpive të shkatërruara në Shqipëri, duke bashkëngjitur pjesës tjetër që shuma konkrete për këtë destinim të propozohet nga Kryetari ose Kuvendi.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, rreth çështjeve që cekura nga parafolësit mund të sqaroj se shuma e mjeteve, mënyra e ndarjes dhe burimi ku mund të merren mjete buxhetore është e çështje e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Sa i përket propozimit për mos dekorimin e qytetit, ne kemi shqyrtuar mundësinë që dekorimet e qytetit për fund vit të mos bëhen, e kemi në proces të prokurimit por nëse vendoset që të mos bëhet fare dekorimi i qytetit të Podujevës për fund vit kurse shuma e paraparë për këtë çështje me mundësi edhe të gjetjes së shumave tjera, besoj se do ta shqyrtojmë këtë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/01-0091847/19
Podujevë,
05 dhjetor 2019**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**